



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, si dhe në zbatim të nenit 9 dhe në pajtim me nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-209, GZ nr. 77/2010, 16 gusht 2010), të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin N. 05/L-150 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-209 Për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/03 prill 2017), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 25 nëntor 2025, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR LLOGARITË DHE SHËRBIMET NDAJ KLIENTËVE TË BANKËS QENDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

### **KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi**

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e kushteve dhe standardeve për llogaritë, si dhe kryerjen e shërbimeve financiare për klientët e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (tani e tutje “BQK”), në zbatim të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (më tutje Ligji për BQK-në).
2. Në kuadër të qëllimit të përcaktuar ne paragrafin 1 të këtij neni, përmes kësaj rregullore përcaktohen kategoritë e klientëve, klientët si dhe shërbimet financiare që ofron BQK-ja sipas kategorive përkatëse të klientëve.

#### **Neni 2 Fushëveprimi**

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha kategoritë e klientëve dhe klientët e BQK-së të përcaktuar sipas Nenit 9 të Ligjit për BQK-në të definuar në nenin 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje.

#### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë sikurse në Ligjin për BQK-në, si dhe/ose siç janë përkufizuar në vijim për qëllimin e kësaj rregullore:
  - 1.1. **Klient** – nënkupton Institucionet Financiare, Subjektet Publike dhe Institucionet ndërkombëtare të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit për BQK-në;

- 1.2. **Shërbimet e hapjes dhe administrimit të llogarive** – nënkuptojnë aktivitetet e hapjes, administrimit, mirëmbajtjes dhe mbylljes së llogarive të klientëve;
- 1.3. **Shërbimet e depozitimit dhe tërheqjes së parave të gatshme** – nënkuptojnë operacionet e transaksioneve me para të gatshme me qëllim të sigurimit të furnizimit adekuat me kartëmonedha dhe monedha për rregullimin e transaksioneve me para të gatshme euro të ekonomisë së Republikës së Kosovës;
- 1.4. **Shërbimet e transferit të fondeve vendore dhe ndërkombëtare** – nënkuptojnë transferin e fondeve nga një llogari e klientit të mbajtur në BQK në një llogari të të njëjtit klient të mbajtur në një institucion tjetër vendor ose ndërkombëtar dhe pranimin e fondeve nga një llogari e klientit të mbajtur në një institucion tjetër vendor ose ndërkombëtar në një llogari të të njëjtit klient të mbajtur në BQK;
- 1.5. **Shërbimet e pagesave vendore dhe ndërkombëtare** – nënkuptojnë kryerjen e dhe pranimin e pagesave vetëm për klientët që këto shërbime nuk mund ti kryejnë përmes institucioneve bankare dhe institucioneve jo-bankare që ofrojnë shërbimet e pagesave;
- 1.6. **Shërbimet e qasjes dhe shlyerjes në sistemin e pagesave** – nënkuptojnë shërbimet e qasjes dhe shlyerjes në sistemin e pagesave në përputhje me rregulloret përkatëse për sistemet e pagesave;
- 1.7. **Shërbimet e menaxhimit të rezervave të detyrueshme rregullatore** – nënkuptojnë menaxhimin dhe administrimin e rezervave të detyrueshme që institucionet financiare sipas kornizës ligjore dhe rregullative në fuqi duhet t'i mbajnë në BQK-së;
- 1.8. **Shërbimet e operacioneve të letrave me vlerë (blerje dhe shitje të letrave me vlerë)** – nënkuptojnë administrimin dhe menaxhimin e ankandëve dhe proceseve të tregut primar dhe sekondar të letrave me vlerë në përputhje me rregulloren MF-BQK për tregun primar dhe sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- 1.9. **Shërbimet e depozitave të afatizuara** – nënkuptojnë mundësitë e afatizimit të depozitave për një periudhë të caktuar kohore në përputhje me marrëveshjen për depozitat me afat;
- 1.10. **Shërbimet e mbështetjes emergjente për likuiditet** – nënkuptojnë shërbimet e ofrimit të instrumenteve afatshkurtra për bankat në rastet e mungesës së likuiditetit të tyre të përcaktuara sipas Ligjit për BQK-në dhe rregulloren përkatëse të BQK-së;
- 1.11. **Shërbimet e ruajtjes së aseteve të prekshme** – nënkuptojnë shërbimet e ruajtjes së aseteve me vlerë, të cilat ruhen nga BQK-ja por nuk paraqiten si zëra bilancor në raportet financiare të BQK-së;
- 1.12. **Shërbimet e përkujdesjes/kujdestarisë të cilat rrjedhin nga detyrat dhe përgjegjësitë e BQK-së** – nënkuptojnë shërbimet e specializuara që kanë të bëjnë me administrimin, ruajtjen dhe menaxhimin e aktiveve financiare në emër të klientëve dhe për shërbime specifike të kujdestarisë;
- 1.13. **Bankat** – nënkuptojnë institucionet financiare që ofrojnë shërbime financiare në përputhje me ligjin për bankat institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo-bankare;

- 1.14. **Institucionet mikro-financiare** – nënkuptojnë institucione mikro-financiare që ofrojnë shërbime financiare në përputhje me ligjin për bankat, institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo-bankare;
- 1.15. **Institucionet financiare jo-bankare** – nënkuptojnë institucione financiare jo-bankare që ofrojnë shërbime financiare në përputhje me ligjin për bankat, institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo-bankare;
- 1.16. **Institucionet e pagesave dhe institucionet e parave elektronike** – nënkuptojnë institucionet financiare të licencuara dhe autorizuara për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe/apo shërbimeve të parave elektronike në përputhje me ligjin për shërbimet e pagesave;
- 1.17. **Kompanitë e Sigurimeve** – nënkuptojnë institucionet financiare që ofrojnë ofrojnë shërbime financiare në përputhje me ligjin për sigurimet;
- 1.18. **Byroja Kosovare e Sigurimit** – nënkupton institucion financiar që kryen aktivitetin e vet në përputhje me ligjin për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia;
- 1.19. **Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë** – nënkupton institucion financiar që kryen aktivitetin e vet në përputhje me ligjin mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë;
- 1.20. **Fondi Kosovar për Garanci Kreditore** – nënkupton institucion financiar që kryen aktivitetin e vet në përputhje me ligjin për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore;
- 1.21. **Fondet e tjera qendrore me interes publik** – nënkuptojnë institucionet e tjera financiare që menaxhojnë asete me interes për publikun dhe janë të ngjashme me Fondin e Sigurimit të Depozitave në Kosovë dhe Fondin Kosovar për Garanci Kreditore;
- 1.22. **Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës** – nënkupton institucion financiar që kryen aktivitetin e vet në përputhje me ligjin për fondet pensionale të Kosovës;
- 1.23. **Fondet e tjera Kosovare të Pensioneve** – nënkuptojnë institucione financiare që kryejnë aktivitetin e vet në përputhje me ligjin për fondet pensionale të Kosovës;
- 1.24. **Institucionet qeveritare dhe komunat e Kosovës** – nënkuptojnë Thesarin dhe të gjitha institucionet buxhetore, duke përfshirë të gjitha agjencitë e saj si dhe komunat e Kosovës;
- 1.25. **Institucionet e tjera të pavarura publike** – nënkuptojnë institucionet e tjera publike të pavarura sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe/apo Ligjeve të veçanta që mbajnë llogari në Thesar;
- 1.26. **Agjencia Kosovare e Privatizimit** – nënkupton institucionin e pavarur publik që kryen aktivitetin e vet në përputhje me ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- 1.27. **Ndërmarrjet publike qendrore dhe rajonale-lokale** – nënkuptojnë ndërmarrje publike që ofrojnë shërbime me interes publik që kryejnë aktivitetin e vet në përputhje me ligjin për ndërmarrjet publike;
- 1.28. **Bankat e huaja qendrore** – nënkuptojnë institucionet monetare dhe rregullatore të vendeve të tjera funksionet e të cilave janë të ngjashme me ato të BQK-s;
- 1.29. **Bankat e huaja të nivelit të dytë** – nënkuptojnë institucione bankare private që operojnë në vendet e tjera dhe kryejnë shërbime të ngjashme si bankat vendore;

- 1.30. **Qeveritë e huaja** – nënkuptojnë institucione që përfshijnë qeveritë e shteteve të vendeve të tjera me të cilat Kosova ka marrëdhënie financiare dhe/ose tregtare;
- 1.31. **Institucionet financiare ndërkombëtare** – nënkuptojnë institucionet financiare ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Evropiane e Investimeve dhe të ngjashme;
- 1.32. **Organizatat ndërkombëtare** – nënkuptojnë institucionet ndërkombëtare të krijuara sipas të drejtës ndërkombëtare dhe me marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë shteteve si Organizata e Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe të ngjashme;
- 1.33. **Organizatat donatore** – nënkuptojnë institucionet donatore ndërkombëtare që ofrojnë ndihmë financiare, teknike ose materiale për të forcuar demokracinë, ekonominë dhe sektorët e ndryshëm social në Republikën e Kosovës.

## **KAPITULLI II**

### **HAPJA E LLOGARIVE TË KLIENTËVE DHE KATEGORIZIMI I TYRE**

#### **Neni 4**

##### **Hapja e llogarive për klientët e pranueshëm**

1. Në përputhje me dispozitat e nenit 9 të Ligjit për BQK-në, për ti realizuar qëllimet e saj BQK-ja mund të hapë dhe të mbajë në librat e saj llogari të parave dhe letrave me vlerë për bankat dhe institucionet e tjera financiare, subjektet publike si dhe bankat e huaja, bankat qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare dhe sipas kërkesës qeveritë e huaja, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat donatore. Në përputhje me këtë nen klientët e pranueshëm për të hapur llogari dhe për të kryer shërbime në BQK janë:
  - 1.1. Institucionet financiare:
    - 1.1.1. Institucionet bankare;
    - 1.1.2. Institucionet mikro-financiare dhe jo-bankare;
    - 1.1.3. Institucionet e pagesave dhe institucionet e parave elektronike;
    - 1.1.4. Institucionet e siguruesve;
    - 1.1.5. Fondet me interes publik për sigurimin e depozitave dhe fondet për garanci kreditore;
    - 1.1.6. Fondet Pensionale.
  - 1.2. Subjektet publike:
    - 1.2.1. Institucionet publike;
    - 1.2.2. Ndërmarrjet publike.
  - 1.3. Institucionet ndërkombëtare, qeveritë e huaja dhe bankat e huaja:
    - 1.3.1. Institucionet, organizatat financiare dhe donatore ndërkombëtare, qeveritë e huaja dhe bankat e huaja.

## **Neni 5**

### **Kategorizimi i Klientëve**

1. Llogaritë e klientëve të përcaktuar në nenin 4, në varësi të aktiviteti dhe grupimit të tyre ndahen në nën-kategori përkatëse. Nën-kategorizimi bëhet për nga lloji i veprimtarisë së klientëve dhe përkufizimeve ligjore të Ligjit për BQK-në për secilën kategori dhe nënkategori përkatëse ose të ligjit specifik që rregullon veprimtarinë përkatëse të klientit. Mbi këtë bazë klientët kategorizohen:

#### 1.1. Institucionet financiare:

##### 1.1.1. Institucionet bankare:

- a. Bankat.

##### 1.1.2. Institucionet mikro-financiare dhe jo-bankare:

- a. Institucionet mikro-financiare;
- b. Institucionet financiare jo-bankare;
- c. Institucionet e tjera financiare jo-bankare.

##### 1.1.3. Institucionet e pagesave dhe institucionet e parave elektronike:

- a. Institucionet e pagesave;
- b. Institucionet e parave elektronike.

##### 1.1.4. Institucionet e siguruesve:

- a. Kompanitë e Sigurimeve;
- b. Byroja Kosovare e Sigurimit.

##### 1.1.5. Fondet me interes publik për sigurimin e depozitave dhe fondet për garanci kreditore:

- a. Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë;
- b. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore;
- c. Fondet e tjera qendrore me interes publik.

##### 1.1.6. Fondet Pensionale:

- a. Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës;
- b. Fondet e tjera Kosovare të Pensioneve.

#### 1.2. Subjektet publike:

##### 1.2.1. Institucionet publike:

- a. Institucionet qeveritare dhe komunitat e Kosovës;
- b. Institucionet e tjera publike të pavarura;
- c. Agjencia Kosovare e Privatizimit.

##### 1.2.2. Ndërmarrjet publike:

- a. Ndërmarrjet publike qendrore;
- b. Ndërmarrjet publike rajonale-lokale.

### 1.3. Institucionet ndërkombëtare, qeveritë e huaja dhe bankat e huaja:

#### 1.3.1. Institucionet organizatat financiare dhe donatore ndërkombëtare, qeveritë e huaja dhe bankat e huaja

- a. Bankat e huaja qendrore;
- b. Bankat e huaja të nivelit të dytë;
- c. Qeveritë e huaja;
- d. Institucionet financiare ndërkombëtare;
- e. Organizatat ndërkombëtare;
- f. Organizatat donatore.

## **KAPITULLI III**

### **SHËRBIMET E OFRUARA**

#### **Neni 6**

##### **Shërbimet Financiare**

1. BQK ofron shërbimet e saj ndaj klientëve vetëm në përputhje me objektivat dhe detyrat e saj të përcaktuara me Ligjin për BQK-në. Këto shërbime mund të ofrohen vetëm në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara nga BQK-ja.
2. Shërbimet e pagesave (brenda dhe jashtë vendit) të specifikuar në paragrafin 3.4 të këtij neni nuk mund të ofrohen nga BQK-ja për klientët që këto shërbime mund ti kryejnë përmes institucioneve bankare dhe institucioneve jo-bankare që ofrojnë shërbimet e pagesave.
3. Kategoritë e shërbimeve të ofruara nga BQK janë:
  - 3.1. Shërbimet e hapjes dhe administrimit të llogarive:
    - 3.1.1. Hapja e llogarive;
    - 3.1.2. Administrimi i llogarive.
  - 3.2. Shërbimet e depozitimit dhe tërheqjes së parave të gatshme:
    - 3.2.1. Depozitimi i kartëmonedhave;
    - 3.2.2. Depozitimi i monedhave;
    - 3.2.3. Tërheqja e kartëmonedhave;
    - 3.2.4. Tërheqja e monedhave.
  - 3.3. Shërbimet e transferit të fondeve vendore dhe ndërkombëtare:
    - 3.3.1. Transferet ardhëse të fondeve vendore;
    - 3.3.2. Transferet ardhëse të fondeve ndërkombëtare;
    - 3.3.3. Transferet dalëse të fondeve vendore;
    - 3.3.4. Transferet dalëse të fondeve ndërkombëtare.

- 3.4. Shërbimet e pagesave vendore dhe ndërkombëtare:
  - 3.4.1. Pagesat ardhëse vendore;
  - 3.4.2. Pagesat ardhëse ndërkombëtare;
  - 3.4.3. Pagesat dalëse vendore;
  - 3.4.4. Pagesat dalëse ndërkombëtare.
- 3.5. Shërbimet e qasjes dhe shlyerjes në Sistemin e Pagesave;
  - 3.5.1. Qasje në sistemin e shlyerjeve bruto në kohë reale – RTGS;
  - 3.5.2. Qasje në sistemin e shlyerjeve neto – ACH;
  - 3.5.3. Qasje në sistemin e pagesave të shpejta – TIPS;
  - 3.5.4. Hapja dhe administrimi i llogarive të rezervës;
  - 3.5.5. Hapja dhe administrimi i llogarive të shlyerjes dhe/ose llogarive tjera teknike të parapara nga rregulloret e sistemeve të pagesave për qëllime të shlyerjes së pagesave;
  - 3.5.6. Shlyerjet brenda-ditore.
- 3.6. Shërbimet e menaxhimit të rezervave të detyrueshme rregullatore;
- 3.7. Shërbimet e operacioneve të letrave me vlerë (blerje dhe shitje të letrave me vlerë):
  - 3.7.1. Qasje në sistemin e operacioneve të tregut primar të letrave me vlerë – CSD;
  - 3.7.2. Qasje në sistemin e operacioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë – CSD.
- 3.8. Shërbimet e depozitave të afatizuara:
  - 3.8.1. Afatizimi i mjeteve.
- 3.9. Shërbimet e mbështetjes emergjente për likuiditet;
- 3.10. Shërbimet e ruajtjes së aseteve të prekshme;
- 3.11. Shërbimet e përkujdesjes/kujdestarisë të cilat rrjedhin nga detyrat dhe përgjegjësitë e BQK-së.

## **Neni 7**

### **Shërbimet sipas Kategorive të Klientëve**

1. Shërbimet për kategoritë e klientëve mund të ofrohen vetëm për klientët e përcaktuar në nenin 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje.
2. Secila kategori e shërbimeve që i ofrohet një klienti duhet të jetë pjesë e shërbimeve të përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje.
3. Ndërlidhja e shërbimeve të përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje me kategorinë e klientëve të përcaktuar në nenin 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje, mund të ofrohen vetëm pas përmbushjes së kërkesave specifike të përcaktuara me rregulloret përkatëse që adresojnë shërbimin specifik.
4. Klientët e përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje u ofrohen kategoritë e shërbimeve të përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje si në vijim:

- 4.1. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Bankat, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1, 3.2, 3.3, 3.5, 3.6, 3.7 dhe 3.9 të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- 4.2. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Institucionet mikro-financiare, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1 dhe 3.3 të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- 4.3. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Institucionet financiare jo-bankare, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1 dhe 3.3 të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- 4.4. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Institucionet e tjera financiare jo-bankare, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1 dhe 3.3 të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- 4.5. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Institucionet e pagesave, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1, 3.3 dhe pikat 3.5.1, 3.5.2, 3.5.3, 3.5.5 dhe 3.5.6 të nënparagrafit 3.5, të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- 4.6. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Institucionet e parave elektronike, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1, 3.3 dhe pikat 3.5.1, 3.5.2, 3.5.3, 3.5.5 dhe 3.5.6 të nënparagrafit 3.5 të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- 4.7. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Kompanitë e Sigurimeve, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1, 3.3 dhe 3.6 të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- 4.8. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Byronë Kosovare të Sigurimit, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1 dhe 3.3 të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- 4.9. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Fondin e Sigurimit të Depozitave në Kosovë, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1, 3.3 dhe 3.4 të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- 4.10. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1, 3.3 dhe 3.4 të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- 4.11. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Fondet e tjera qendrore me interes publik, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1, 3.3 dhe 3.4 të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- 4.12. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1, 3.3, 3.4 dhe pikat 3.5.1, 3.5.2 dhe 3.5.6 të nënparagrafit 3.5 dhe nënparagrafin 3.7, të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- 4.13. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Fondet e tjera Kosovare të Pensioneve, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1, 3.3, 3.4 dhe pikat 3.5.1, 3.5.2 dhe 3.5.6 të nënparagrafit 3.5 dhe nënparagrafin 3.7, të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- 4.14. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Institucionet qeveritare dhe komunat e Kosovës, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1, 3.3, 3.4, pikat 3.5.1, 3.5.2, 3.5.3, 3.5.5 dhe 3.5.6 të nënparagrafit 3.5, nënparagrafin 3.7, nënparagrafin 3.8 dhe nënparagrafin 3.10, të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- 4.15. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Institucionet e tjera publike të pavarura, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1, 3.3 dhe 3.4 të përcaktuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje;
- 4.16. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1, 3.3, 3.4 dhe 3.10 të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- 4.17. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Ndërmarrjet publike qendrore, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1 dhe 3.3 të nenit 6 të kësaj rregulloreje;

- 4.18. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Ndërmarrjet publike rajonale-lokale, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1 dhe 3.3 të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- 4.19. Kategoritë e shërbimeve të ofruara për Bankat e huaja qendrore, Bankat e huaja të nivelit të dytë, Qeveritë e huaja, Institucionet financiare ndërkombëtare, Organizatat ndërkombëtare dhe Organizatat donatore, janë të përcaktuara në nënparagrafin 3.1, 3.3 dhe 3.11 të nenit 6 të kësaj rregulloreje.

## **KAPITULLI V**

### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 8**

##### **Dispozitat Kalimtare**

Llogaritë ekzistuese të klientëve duhet përshtaten me kërkesat e kësaj rregulloreje brenda një periudhe prej 6 (gjashtë) muajve pas miratimi të kësaj rregulloreje.

#### **Neni 9**

##### **Dispozitat Përfundimtare**

1. Brenda një periudhe prej 6 (gjashtë) muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje dhe akteve tjera nënligjore të ndërlidhura me këtë rregullore, të gjithë klientët duhet të pranojnë dhe nënshkruajnë kushtet dhe afatet e reja në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë rregullore dhe me aktet tjera nënligjore që rregullojnë procedurat përkatëse mbi menaxhimin dhe administrimin e llogarive të klientëve.
2. Bordi Ekzekutiv përmes rregullatives së brendshme përcakton njësitë organizative të BQK-s për zbatim të kësaj rregulloreje.
3. Aspektet tjera teknike do rregullohen përmes politikave, rregullave, procedurave dhe akteve të tjera nënligjore bazuar në përgjegjësitë e deleguara sipas nenit 36 të Ligjit për BQK.

#### **Neni 10**

##### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi më 15 dhjetor 2025, me përjashtim të nënparagrafëve 4.5 dhe 4.6 të nenit 7, që do të zbatohen me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave dhe kërkesave përkatëse rregullative.

Dr. Sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës